



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 27.09.2018  
Dokument parlamentar

**R A P O R T**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7895, DATË 27.01.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR””  
(NISMË E 37 MIJË ZGJEDHËSVE)**

**Drejtuar: Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.**

Komisioni parlamentar për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjen e datës 27.09.2018 projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (*nismë e 37 mijë zgjedhësve*).

Për prezantimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”” (*nismë e 37 mijë zgjedhësve*) u ftuan të ishin pjesëmarrës në mbledhjen e komisionit, përfaqësues të inicuesve të nismës dhe konkretisht, prezantimi i nismës u bë nga organizata jofitimprurëse në ndihmë të kafshëve “Animal Rescue Albania”. Në mbledhjen e komisionit u ftuan gjithashtu dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit .

Për projektligjin në fjalë, relatoi kryetarja e komisionit znj.Ermonela Valikaj (Felaj).

**I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT**

Qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i Kodit Penal dhe shtimi në të i një kreu të ri, kreu XII , i titulluar “Veprat penale kundër mirëqënies së kafshëve” , nismë kjo e inicuar me

nënshkrime të 37500 qytetarëve me të drejtë vote, konform nenit 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

## **II. ÇËSHTJET KRYESORE QË TRAJTON PROJEKTLIGJI**

Projektligji shton kreun XII “ Vepra penale kundër mirëqënies së kafshëve” i përbërë nga 6 nene:

**Neni 1** i projektligjit, parashikon dënime me burg nga gjashtë muaj deri në dy vite për cilindo që me ligësi apo pa arsye vret një kafshë.

**Neni 2** i projektligjit, parashikon dënime me gjobe dhe me burgim për cilindo që pa arsye të ligjshme i braktis apo i keqtrajton kafshët.

**Neni 3** i projektligjit, parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që promovon, organizon apo drejton ndeshje ndërmjet kafshëve duke i shkaktuar vuajtje apo tortura.

**Neni 4** i projektligjit, parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që kryen eksperimente me kafshët

**Neni 5** i projektligjit parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që përdor lëkurën e kafshëve të shoqërimin dhe individëve të faunës së egër në rrezik zhdukje.

**Neni 6** i projektligjit parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që vret dhe robëron individët e faunës së egër në rrezik zhdukje.

## **III. DISKUTIME NË KOMISIONIN PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Për prezantimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”” (*nismë e 37 mijë zgjedhësve*) ishin të ftuar përfaqësues nga organizata jofitimprurëse në ndihmë të kafshëve “Animal Rescue Albania” si dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit .

Gjatë diskutimeve në komision, kryetarja e komisionit znj.Felaj i falënderoi iniciatorët për nismën, duke theksuar faktin se nismat e qytetarëve për të iniciuar një ligj nuk janë shumë të ndeshura dhe ky është një shembull i mirë që kjo organizatë po jep në opinionin publik.

Në vijim të relatimit znj.Felaj theksoi se kjo nismë synon të amendojë Kodin Penal duke i shtuar atij një kre të ri, i cili lidhet me trajtimin e kafshëve, atyre të rrugës por jo vetëm. Propozohet që Kodit Penal t’i shtohen 6 (gjashtë) vepra penale të reja, të cituara si më lart.

Kodi Penal është ligj i cilësuar, është ligj me natyrë ndëshkuese dhe ndërshkimet janë të tilla që kryesisht heqin ose kufizojnë lirinë e personave.

Në këtë pikëpamje, sa herë që ka një nismë për amendimin e Kodit Penal, Komisioni i Sigurisë Kombëtare ka tagrin për t' u shprehur për këto nisma qofshin ato të qytetarëve, apo të subjekteve të tjera që Kushtetura u njeh të drejten e inicimit të një procesi ligjvënës, në mënyrë që të cmojë nismën në raport me përmbajtjen dhe strukturën aktuale të Kodit Penal, e në rastin konkret të çmojë balancën ndërmjet nevojës për të mbrojtur dhe mirëtrajtuar kafshët dhe premisave të reja që propozohen si shkak për heqjen e lirisë së shtetasve.

Kreu që propozohet për amendim në Kodin Penal, përmban gjithsej 6 dispozita e që sipas propozuesve përfaqësojnë figura ose shfaqje të ndryshme të kryerjes së veprimeve të dhunshme ndaj kafshëve. Të gjitha këto figura të reja, propozohen si figura krimi dhe jo kundërvajtje penale.

Kodi Penal aktual, në kreun IV të tij, të titulluar “Veprat penale kundër mjedisit”, përmban disa nene, neni 201-207, nene në të cilat trajtohen ndotja e ajrit, transportimi i mbeturinave toksike, ndotja e ujërave, peshkimi i ndaluar, prerja e paligjshme e pyjeve, prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor, shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor dhe shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve.

Pra aktualisht, ajo çfarë përfaqëson mjedisi, flora dhe fauna, gjejnë mbrojtje në këtë kre të Kodit Penal, me këto nene dhe logjika juridike do e kërkonte që edhe nisma e sjellë në Kuvendin e Shqipërisë për mbrojtjen nga dhuna të kafshëve, të mund të trajtohej në këtë kre ose minimalisht në raport me këtë kre, i cili për hir të së vërtetës duhet të reformohet, sepse është nga të paktët krerë të Kodit Penal ku nuk është ndërhyrë ose është ndërhyrë shumë rrallë duke mos reflektuar veprime ose mosveprime me pasoja shumë të rënda ndaj mjedisit, dhe indirekt edhe ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve .

Znj.Felaj theksoi se sikundër qytetarët marrin iniciativa dhe propozojnë nisma, ashtu edhe autoritetet dhe institucionet qendrore, e kanë për detyrë të sjellin nisma ligjore që të reflektojnë të gjitha realitetet e reja që janë shqetësuese për shoqërinë dhe kohën në të cilën jetojmë.

Dispozitat e propozuara nga nismëtarët e këtij projekti, pa hyrë në analizën e përmbajtjes një për një të tyre e kalojnë numrin e veprave penale që përmbajnë krerë të tjerë të Kodit Penal shumë herë më të rëndësishëm përsa i përket objektit të tyre .

Kodi Penal ka një balancë, një gjuhë teknike dhe një strukturë të caktuar sa i takon vendit në kod të cdo veprë, një strukture dhe një logjikë të caktuar për dënimet qofshin këto kryesore plotësuese, e cila duhet të respektohet domosdoshmërisht.

Kodi Penal është ligji i cilësuar dhe si i tillë duhet të bëhet shumë kujdes me shkrimin në të dhe ndërhyrjet në kohë dhe për shkaqe të ndryshme.

Në rastin konkret, duhej mbajtur parasysh që jo cdo lloj sjellje ose veprim i papranueshëm përkundërt kafshëve, është i tillë që mund të ngrihet në nivelin e një veprë penale ose figure të saj e për rrjedhojë të cojë në ndëshkimin penal të shtetasve.

Edhe legjislacione të tjera, fqinjë ose të vendeve të BE, nuk i kushtojnë të njëjtën hapësirë në kodet e tyre çështjes në fjalë .

Nga ana tjetër është e qartë vështirësia që hasin 20 mijë qytetarë për të shkruar një projekt të tillë ligjor dhe sfida për ta sjellë në një formë mirëfilli ligjore, sepse edhe kapacitetet teknike dhe *background*-i, nuk janë të tilla që ndihmojnë të shkruhet një ligj ose amendime të një ligji.

Të gjitha figurat propozohen si krime, nuk ka propozim për asnjë kundërvajtje penale. Masat e dënimit të propozuara, janë dukshëm më të larta sesa ato për vepra penale edhe më të rënda. Propozohen dy lloj dënimesh kryesore njëherazi, dënimi me gjobë dhe dënimi me burg, cfarë më herët është shpallur dhe si antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese.

Nismës i mungon një relacion shpjegues për dispozitat e propozuara, i mungon justifikimi publik në drejtim të argumentave për secilën nga veprat penale që kërkohet të bëhen pjesë rishtas të Kodit Penal. Nga nismëtarët kjo u justifikua me faktin se përcaktimi kushtetues për të drejtën e inicimit të procesit ligjvënës nuk e detyron dikë të tillë.

Kushtetuta përmban norma abstrakte të cilat detajohen më tej nëpërmjet ligjeve. Për iniciativën qytetare për propozimin e një ligji, mungojnë modalitetet e ushtrimit të saj, vetëm aktualisht Kuvendi i Shqipërisë është duke diskutuar për një nismë të tillë për të cilën ka kërkuar opinion dhe nga Komisioni i Venecias.

Kodi Penal dhe legjislacioni penal në përgjithësi, i kanë të mirëpërcaktuara saktësisht detyrat e tyre, sipas një rendi që ndjek shkallën e rëndësisë së marrëdhënieve juridike konkrete që merren në mbrotje .

### ***Neni 1/b i Kodit Penal Detyra e legjislacionit penal***

***Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit, dinjetetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre.***

Është e qartë që ky kontekst i detyrave të legjislacionit penal, detyron qartësisht rishikimin ose rishkrimin e nismës, në mënyrë të tillë që në kod të reflektohet cfarë realisht është e nevojshme dhe e domosdoshme, që përbën shfaqjen më të përpahur, më të rrezikshme dhe më të vështirë për t'u parandaluar në mënyra dhe mjete të tjera.

Po kështu, është rasti për të sugjeruar një ligj të posacëm për mbrojtjen e kafshëve cfarë duket më e përshtatshme në nevojën për të trajtuar çdo sjellje, çdo trajtim jo të duhur të kafshëve dhe shpendëve, sikundër nga legjislacioni aktual, mund të rishikohet ligji “Për shërbimin veterinar”, ligj i cili një ndër qëllimet e veta ka pikërisht atë që lidhet me mirëqënien e kafshëve.

Pra, duke ecur kështu hap pas hapi, u sugjerua që kontributit dhe iniciativës së ndërmarë nga shoqëria civile duhet t'i bashkohen si Ministria e Drejtësisë ashtu edhe Ministria e Mjedisit me qëllim që ky draft të mund ta silltet në formën dhe në gjuhën e duhur

#### **IV. PËRFUNDIME**

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, duke vlerësuar qëllimin e mirë të nismës, sugjeroi që kjo nismë të ripunohet, duke bashkuar në një kontributin e organizatës në ndihmë të kafshëve dhe atë të institucioneve qendrore, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, për t'i dhënë formën e duhur ndryshimeve në Kodin Penal.

**KRYETARE/ RELATORE**

**ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)**

